



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.160 dt.06.11.1998

**PER CELJEN E FONDIT TE BLERJES SE DY AUTOMJETEVE PER
TRANSPORTIN E KUFOMES PER NDERMARRJEN E SHERBIMEVE
FUNERALE TIRANE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.06.11.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) “Propozim për çeljen e fondit të blerjes së dy automjeteve për transportin e kufomës për N.SH.Funerale” në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, si dhe VKM Nr.158, dt.11.04.1994 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të Pushtetit Lokal”

VENDOSI

1. Të miratojë çeljen e fondit prej 5.000.000 lekë për blerjen e dy automjeteve për transportin e kufomës për N.SH.Funerale.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgj. Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI